

KONFLIKTI NË BOSNJE DHE HERCEGOVINË DHE MARRËVESHJA E
DEJTONIT

TEMA PËR TITULLIN
MASTER NË INTEGRIM EVROPIANE DHE ADMINISTRATË PUBLIKE

NGA

LIRIM XHIMI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
INTEGRIM EVROPIAN DHE ADMINISTRATË PUBLIKE
PRISHTINË

TETOR, 2021

KONFLIKTI NË BOSNJE DHE HERCEGOVINË DHE MARRËVESHJA E DEJTONIT

Mentori: Prof. Ass. Dr. Adem Beha

Ky punim është për konfliktin e Bosnje dhe Hercegovinës, për arsyet se përse ka ndodhur ky konflikt dhe ndikimin që ka pasur Marrëveshja e Dejtonit në përfundimin e konfliktit. Ky punim është i tipit kualitativ, të dhënat e përdorura janë dytësore, siç janë rishikimi i literaturës nga libra të ndryshme, revista dhe punime shkencore që janë marrë me këtë temë. Në këtë punim janë pesë kapituj, në kapitullin e parë është korniza teorike, në të është shtjelluar për teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në kapitullin e dytë flitet për arsyet se përse ka ndodhur konflikt në Bosnje dhe Hercegovinë. Në kapitullin e tretë shtjellohet për pavarësinë e Bosnje dhe Hercegovinës, për Republikën Srpska dhe planet Carrington e Vance-Owen. Ndërsa, në kapitullin e katërt shpjegohet për Marrëveshjen e Uashingtonit dhe Masakrën e Srebrenicës në të cilën u vranë mbi 8 mijë persona të pafajshëm edhe pse ky vend ishte nën mbrojtjen e Kombeve të Bashkuara. Në kapitullin e fundit është shtjelluar për Marrëveshjen e Dejtonit e cila e ndali luftën dhe e ka ‘konsoliduar’ shtetin e Bosnje dhe Hercegovinës.

PËRMBLEDHJE

Konflikti i Bosnje dhe Hercegovinës ishte vazhdimësi e konflikteve që kishin filluar pas vitit 1990 dhe njëkohësisht ky ishte edhe konflikti më i gjatë i zhvilluar në ish Federatën Jugosllave, ky konflikt zgjati rreth 3 vite. Para këtij konflikti, kishte pasur edhe konflikte në Slloveni dhe Kroaci por aty zgjatën shumë më pak dhe ato kishin fituar pavarësinë, pas tyre edhe Bosnja dhe Hercegovina filloi nisjen për shkëputjen nga Federata Jugosllave. Problemet në këtë Federatë kishin filluar që nga vitet e '70 me krizën ekonomike që kishte kapluar këtë vend, poashtu një ndihmës për prishjen e rehatisë në Federatë kishte ardhur pas vdekjes së Presidentit Josip Tito, duke thelluar kështu krizën edhe në aspektin politik. Pas vdekjes së Titos, filloi rritja e nacionalizmit serb për ‘Serbin e madhe’ dhe nga këtu filluan ndarjet etnike në federatë. Në Bosnje dhe Hercegovinë ndikim të madhe për prishjen e raportit në mes Federatës Jugosllave dhe Bosnjës kishte ndikim edhe skandali ‘Agrokomerc’, në të cilën ishte i përfshirë anëtari boshnjak i këshillit presidencial, Hamdija Povzderac, që ishte përgjegjës për pjesën më të madhe të borxhit

në Agrokomerc. Povzderac ishte planifikuar të bëhej president i Jugosllavisë vitin e ardhshëm. Pra, këto janë disa nga arsytet që kanë dërguar në konfliktin e Bosnje dhe Hercegovinës; rritja e nacionalizmit, kriza ekonomike, skandali Agrokomerc, problemet etnike dhe fetare dhe politika e paunifikuar e boshnjakëve.

Pas këtyre zhvillimeve dhe prishjes së raporteve të etnive që jetonin në Bosnjë filluan diskutimin për një Bosnje të bashkuar. Alija Izetbegović nuk besonte që këto bisedime do të sjellnin ndonjë sukses i ndërpreu këto dhe e shpalli referendumin për shpalljen e pavarësisë, edhe pse në referendum nuk e mori aprovimin nga qytetarët e Bosnjës, siç kërkohej me kushtetut 2/3 e votave, ai prap shpalli pavarësinë me 3 prill 1992, por këtë e kundërshtuan serbët e Bosnjes. Forcat e armatosura të serbëve në krye me Radovan Karaxhiçin e marrin si pretext shkeljen e kushtetutës nga ana e Izetbegovićit me shpalljen e pavarësisë dhe filluan që të sulmojnë mbi boshnjakët dhe kroatët, gjithashtu ata formojnë 'Republika Srpska' brenda Bosnjës. Të gjitha palët filluan që të luftojnë në mes veti dhe lufta kryesore u zhvillua në Sarajevë, e cila ma herët njihej si qyteti me multi-etnik që jetonin pa probleme.

Sarajeva ishte pika kryesore e konfliktit, të gjitha palët synonin që të shtrinin ndikimin e tyre në kryeqytet. Situata në Sarajevë shkonte e përkeqësohej çdo ditë e më shumë, kjo ndjehej nga banorët që nuk kishin ndikim politik dhe ishin keq në aspektin ekonomik, që shpesh herë vuanin edhe për ushqim, për shkak të çmimit të lartë të produkteve. Këtë problem nuk e kishin personat të cilët ishin mirë në aspektin financiar dhe kishin fuqi në aspektin politik sepse të tillët mund të largoheshin kurdo herë nga Sarajeva përmes tunelit apo aeroportit dhe nuk ishin objekt i luftës dhe interesave të grupeve qoftë qeverisë boshnjake apo ushtrisë serbe. Kishte iniciativa të ndryshme nga akterët ndërkombëtar për të parandaluar konfliktin, ishte Plani Carrington dhe Plani Vance-Owen, por dyjat ishin pa efekt.

Pas shumë rezolutave nga OKB, të gjitha rezultuan të pasukseshme dhe gjithashtu të pa përfillshme nga akterët në Bosnjë, më saktë nga Republika Srpska, Mirëpo një takim në Uashington sollti rezultat, në mars 1994, nën presionin e madh nga amerikanët dhe gjermanët, Presidenti i Kroacisë, Tudjman dhe Presidenti i Bosnjës, Izetbegović ranë dakord t'i japin fund luftimeve midis kroatëve dhe boshnjakëve muslimanëve. Kjo e ashtuquajtur "Marrëveshje e Uashingtonit" në thelb përbëhej nga një Kushtetutë për një Federatë midis muslimanëve boshnjakë dhe kroatëve boshnjakë, e cila më vonë do të bëhej një nga dy "entitetet" e Bosnjës.

Më 16 Prill 1995, Srebrenica u caktua një 'zonë e sigurt' e KB dhe më 17 Prill u bë marrëveshja e armëpushimi me shtatë pika, e arritur në aeroportin e Sarajevës nën kujdesin e KB midis udhëheqësve serbë dhe myslimanë të Bosnjës dhe hyri në fuqi. Por, pas një kohe kjo marrëveshje u shkel. Më 12 korrik, Këshilli i Sigurimit në New York ishte mbledhur në séance me urgjencë. Ajo miratoi unanimisht rezolutën 1004 (1995), duke vepruar nën Kapitullin VII të Kartës, ai kërkoi që forcat serbe të Bosnjës të pushonin luftimet dhe të tërhiqen nga zona e sigurt e Srebrenicës menjëherë. Dhe pas kësaj rezolute ndodhi maskara e Srebrenicës që njihet ndryshe si maskara më e tmerrshme që është bërë që nga përfundimi i Luftës së II botërore. Në të cilën u vranë mbi 8 mijë persona të pafajshëm, vetëm pse ishin musliman boshnjakë. Pra, pas luftës më shumë se 3 vjeçare në Bosnje dhe Hercegovinë, aktorët ndërkombëtarë e organizuan 'Konferencën e Dejtonit', për ta ndalur luftën në këtë rajon. Kjo konferencë filloi në Dejton të SHBA-së me 21 nëntor 1995, dhe në fund u nënshkrua në Paris me 14 dhjetor 1995. Në këtë konferencë palë ishin; Republika e Bosnje dhe Hercegovinës, Republika e Kroacisë dhe Republika Federale e Jugosllavisë. Disa nga pikat kyçe ishin, ndalja e luftës, ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut u futën në Marrëveshjen e Paqes në Dejton me qëllim të lehtësimit të një situate në Bosnje dhe Hercegovinë, ku të drejtat e njeriut mund të siguroheshin. Poashtu, në bazë të kësaj marrëveshjeje, Bosnja u nda në dy entitete, njëra e mbizotëruar nga serbët e Bosnjës (Republika Srpska), tjetra nga një koalicion i kroatëve dhe myslimanëve boshnjakë (Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës), me Sarajevën që të jetë kryeqyteti dhe selia e institucionet e përbashkëta të Bosnje dhe Hercegovinës.

Marrëveshja e Dejtonit del që të jetë një eksperiment nga aktorët ndërkombëtarë, për ta ndaluar konfliktin në Bosnje dhe atë që e kishte fituar Republika Srpska në konflikt po atë e fitojë me Marrëveshjen e Dejtonit. Kjo marrëveshje shtetin e Bosnje dhe Hercegovinën e përcakton si shtet të veçantë konsociativ, një konfederat asimetrike e përbërë nga dy entitete; një entitet federal, multietnik që është Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe një entitet unitar që është Republika Srpska, pra një eksperiment. Për fund, Alija Izetbegoviç e konsideroi periudhën e paqes pas Dejtonit si vazhdim të konfliktit të armatosur me mjete të tjera. Për të marrëveshja e paqes do të thotë një luftë me mjete verbale, duke përfshirë mjetet ligjore dhe diplomatike.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E KAPITUJVE

Në kapitullin e parë të këtij punimi është përfshi korniza teorike, në të cilën është shtjelluar për teoritë siç janë; realizmi, liberalizmi dhe konstruktivizmi, për anarkinë ndërkombëtare që në mungesë të një institucioni supranacional nuk ndalen luftërat dhe në fund për konceptin e luftës.

Në kapitullin e dytë tregohen arsyet e nisjes së konfliktit në Bosnje dhe Hercegovinë. Duke filluar nga rritja e nacionalizmit nga të gjithë popujt që jetonin brenda RSFJ. Kriza ekonomike që patë kapluar gjithë botën, por më së shumti ishte vërejtur në Jugosllavi sepse kishte shumë inflacion pavarësisht masave që ishin ndërmarrë nga qeveria. Arsye tjetër ishte skandali i Agrokomercit në vitin 1987, pas zjarrit që kishte ndodhur në fabrikën Agrokomerc, e cila nisi duke hulumtuar për shkaqet e zjarrit, pastaj kishin vërejtur edhe keqpërdorime financiare në të cilën ishte përfshi anëtari boshnjak i këshillit presidencial, Hamdija Pozderac, i cili ishte përgjegjës për pjesën më të madhe të borxhit në Agrokomerc. Pozderac ishte planifikuar të bëhej president i Jugosllavisë vitin e ardhshëm. Pastaj pasuan problemet etnike dhe fetare në Bosnje dhe Hercegovinë, të cilat kishin ndikim negativ në konflikt.

Në kapitullin e tretë është shënuar për shpalljen e pavarësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, të cilën e kanë përkrahur boshnjakët dhe kroatët, ndërsa serbët kanë qenë kundër kësaj dhe si kundërpërgjigje e kanë formuar Republika Srpska në Bosnje. Sarajeva ka qenë pika kyçe e këtij konflikti, që kush e ka pasur nën kontroll Sarajevën ka pasur gjithë Bosnjën.

Në kapitullin e katërt është përfshi masakra e Srebrenicës e cila kishte ndodhur edhe pse vendi ishte nën mbrojtjen e Kombeve të Bashkuara, kjo masakër e kishte ulur kredibilitetin dhe fuqinë e Kombeve të Bashkuara, që mund të bënte ndonjë veprim për ndalimin e konfliktit, poashtu në këtë kapitull është edhe Marrëveshja e Uashingtonit, në të cilën ishte arritur pajtimi në mes boshnjakëve dhe kroatëve për ndaljen e konfliktit, kurse serbët e kishin refuzuar.

Në kapitullin e pestë bëhet fjalë për Marrëveshjen e Dejtonit, për ndalimin e konfliktit kishte pasur pesë negociata të pasuksesshme të paqes ndërmjet shtatorit 1991 dhe 29 nëntorit 1993. Duke mos pasur sukses, SHBA ishte marrë intenzivisht për ndalimin e këtij konflikti i cila po merrte mijëra jetë të pafajshme, ky interesim i SHBASë kishte ardhur pas masakrës së Srebrenicës. Poashtu, në këtë kapitull është shënuar për prapaskenat e bisedimeve për Marrëveshjen e Dejtonit, Korniza kryesore e Marrëveshjes së Dejtonit dhe në fund është shënuar për “eksperimentimin” me Marrëveshjen e Dejtonit.

METODOLOGJIA

Ky punim është i tipit kualitativ, synimi i këtij punimi është të shohim arsyet se përse ka ndodhur konflikti i Bosnje dhe Hercegovinës dhe rëndësia e Marrëveshjes së Dejtonit. Të dhënat janë sekondare, burimet janë rishikimi i literaturës ku janë marrë nga librat që janë për teoritë e konflikteve, për konfliktin në Bosnje dhe Hercegovinë, për Marrëveshjen e Dejtonit dhe gjithashtu kemi marrë burime nga revista, burime nga interneti dhe punime shkencore që janë relevante me temën. Kjo metodë është më adekuate për të arritur deri tek realizimi i qëllimit të këtij punimi. Pra, për hartimin e këtij hulumtimi kemi përdorur metodën historike, metodën e analizës teorike dhe metodën përshkruese. Metodën historike e kemi përdorur për të treguar ngjarjet që kanë ndodhur dhe arsyet që kanë dërguar në fillimin e konfliktit, ndërsa analiza teorike për të parë se si i shpjegojn teoritë këto konflikte dhe metodën përshkruese e kemi bërë përshkrimin e konfliktit 3 vjeçar të Bosnje dhe Hercegovinës.

Punimi synon të jap përgjigje në pyetjen hulumtuese:

 *Cilat janë arsyet e konfliktit në Bosnje dhe Hercegovinë ?*